# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 171 dhe 172 të Qeverisë.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

Nr. 02/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për mënyrën e shkëmbimit të informacioneve dhe notifikimin e rregulloreve teknike, procedurave të vlerësimit të Konformitetit dhe Standardeve.

2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të Dokumenteve Strategjike për vitin 2014**

1. Në planin e dokumenteve strategjike për vitin 2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës përfshihen këto dokumente strategjike:

   1.1 Projekt-strategjia për asistencë në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë 2016-2019 (MD)

   1.2 Projekt-strategjia për reformën rregullative 2014-2020 (ZKM)

   1.3 Projekt-strategjia kundër trafikimit me njerëz 2014-2019 (MPB)

2. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M

1. Themelohet Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile për vitet 2013-2017.

2. Këshilli është struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile.

3. Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile për vitet 2013-2017 në përbërjen e tij ka 29 anëtarë, nga të cilët 14 janë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues nga shoqëria civile.

4. Nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, 14 prej tyre përzgjidhen nga vet organizatat e shoqërisë civile ndërsa 1 emërohet nga Platforma CiviKos.

5. Këshilli udhëhiqet nga:

   5.1. z. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit (Kryesues)
   5.2. z. Habit Hajredini, Drejtor në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, zv. Kryesues
   5.3. Përfaqësuesi i emëruar nga Platforma CiviKos (Bashkëkryesues)

6. Përfaqësuesit tjerë të Qeverisë emërohen nga institucionet në vijim, të cilat përfaqësohen në nivel të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe drejtorëve përgjegjës:

   6.1. Ministria e Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
   6.2. Ministria e Integrimit Evropian, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë

6.3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
6.4. Ministria e Financave, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
6.5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
6.6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
6.7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtarë
6.8. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtarë
6.9. Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtarë
6.10. Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtarë
6.11. Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtori, një anëtarë
6.12. Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Drejtori, një anëtarë
6.13. Zyra Administrative/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtarë.

7. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit shërben si Sekretariat i Këshillit, dhe do të jetë në funksion për të zhvilluar dhe mirëmbajtur të gjitha aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.

8. Procesin e përzgjedhjes së përfaqësueseve të shoqërisë civile në Këshill do ta organizojë Platforma Civikos, në bashkëpunim me Sekretariatin e Këshillit, në bazë të një procedure demokratike, të hapur dhe transparente.

9. Për mbarëvajtjen dhe për një punë të suksesshme të këtij Këshilli, Sekretariati do të mbështetet nga Zyra e Kryeministrit në aspektin financiar dhe me resurse njerëzore.

10. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit mandatohet që në bashkëpunim me Platformën CiviKos të hartojë Termat e Referencës për punën e Këshillit, të cilat do të miratohen në takimin e parë të Këshillit.

11. Obligohet Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi.

12. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë nr.02/167 i datës 22 janar 2014.

13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

# VENDIM

## Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/97 të datës 24 tetor 2012

1. Pika 4. e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/97 të datës 24 tetor 2012 zëvendësohet me tekstin si në vijim: "4. Personeli i Sekretarisë përbëhet nga gjashtë (6) Punëtorë Administrativ me nivel të pagës 350 (treqindepesëdhjetë) euro bruto në muaj.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

# V E N D I M

**Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Qeverisë nr.03/77 të datës 4 qershor 2012 për Themelimin e Grupit Punues Ndërministror për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim (GP BmKP)**

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë Nr. 03/77 i datës 4 qershor 2012 për Themelimin e Grupit Punues Ndërministror për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim (GP BmKP) si në vijim: Pikës 1.13. i shtohet teksti "njëri nga përfaqësuesit nga Shoqëria Civile, zëvendës-kryesues i zgjedhur nga anëtarët e Grupit punues" dhe pika 10. Raportimi, zëvendësohet me këtë tekst "Grupi Punues i paraqet Qeverisë raporte vjetore për miratim. Një kopje e raportit i përcillet Zyrës së BE-së në Kosovë për t'i marrë parasysh në progresin e Kosovës në rrugën e saj drejt BE-së.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

Nr. 07/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M
**Për shfuqizimin e vendimit të Qeverisë nr. 13/150, të datës 2 tetor 2013**

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues për shfuqizimin e vendimit të Qeverisë nr. 13/150, të datës 2 tetor 2013.

2. z. Muharrem Pozhegu, shkarkohet nga pozita e Kryeinspektorit në Inspektoratin e Tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për shkak se Komisioni i Ankesave ka vërtetuar se dokumentacioni i ofruar për këtë pozitë nuk është në pajtim me Legjislacionin në fuqi.

3. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

# V E N D I M

## Për aprovimin e projekt-propozimeve në kuadër të raundit të 11-të të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor

1. Në kuadër të programit të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimorë, raundi i 11-të, Ministria e Integrimit Evropian në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dorëzon këto projekt propozime:

    1.1. Azhurnim i Studimit të Fizibilitetit, dhe azhurnim i Dizajnit të Detajuar Teknik për ndërtimin e rrugës N9 Prishtinë - Pejë (SEETO Route 6A) segmenti Kijevë - Klinë, deri në Zahaq (30 km);
    1.2. Azhurnim i Studimit të Fizibilitetit, dhe azhurnim i Dizajnit të Detajuar Teknik për ndërtimin e autostradës (SEETO Route 7) segmenti E, nga Prishtina deri në Merdare;
    1.3. Studim Identifikimi - krijimi Sistemit të Energjisë së Qarkut për tërë qytetin, dhe Kompanisë së Energjisë së Qarkut në Pejë.

2. Shuma e grantit të kërkuar për projekt propozimin e parë, ndërtimi i rrugës N9 Prishtinë-Pejë, është EUR 0.8 mil. Shuma e grantit të kërkuar për projekt propozimin e dytë, ndërtimi i autostradës Prishtinë - Merdare është EUR 0.5 mil. Shuma e grantit të kërkuar për projekt propozimin e tretë, krijimi Sistemit të Energjisë së Qarkut në Pejë, është EUR 0.15 mil.

3. Për zbatimin e këtij vendimi, dorëzimin e projekt propozimeve dhe përcjelljen e rrjedhës së këtyre aplikacioneve, ngarkohet Ministria e Integrimit Evropian.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet Udhërrëfyesi për vitin 2014 si dokument pune për zbatimin e Reformës së Administratës Publike.

2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhërrëfyesit nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

Nr. 10/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa e Ministrisë së Forcës së Sigurisë për nismën e lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare për statusin e anëtarëve të Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territoret e shteteve përkatëse.

2. Obligohet Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

Nr. 11/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia për zhvillimin e Partneriteteve Publiko-Private në Republikën e Kosovës për vitet 2014-2016.

2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***


Nr. 12/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 33 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti Vjetor për Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit për Komuna për vitin 2013 të Komisionit të Granteve.

2. Obligohen ministritë e linjës dhe komunat për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Vjetor për Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit për Komuna për vitin 2013 të Komisionit të Granteve.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i rrugës "Transiti i Shtimes" që lidhë-Segmentin e III-të (Rrugët nacionale Prishtinë–Prizren, Shtime – Ferizaj) dhe Rrugët Regjionale M25, segmenti rrugor Shtime-Suharekë dhe Lipjan-Shtime, Zonat Kadastrale Shtime, Davidoc Belincë, Petroviq dhe Godanc i Poshtëm, Komuna e Shtimes, sipas tabelave bashkangjitur këtij vendimi.

2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.

3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.

4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.

5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit , ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila

është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.

7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.

8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 14/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

**Për ndryshimin dhe plotësimin të Vendimit Përfundimtar nr. 05/170 të datës 14 shkurt 2014**

1. Aprovohet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit Përfundimtar Nr.05/170 datë 14.02.2014 për Zonën Kadastrale Qagllavicë, Komuna e Prishtinës.

2. Anulohet shpronësimi për ngastrat kadastrale nr.650-0, 683-0, 684-0, 688-0, 686-0,697-1, 698-0, 1144-0, 1133-0, 1132-0, 718-0, 737-0, 738-0,747-0, 748-0 dhe 749-0, Zona Kadastrale Dyz, Komuna e Podujevës.

3. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë, Zona Kadastrale Qagllavicë, Komuna e Prishtinës dhe shpronësimi i përhershëm dhe me vënien e të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i largpërçuesit (shtyllave elektrike) për nevoja të Burgut të Sigurisë së Lartë, Zonat Kadastrale Batllavë, Dyz, Gërdovc dhe Tërnavë, Komuna e Podujevës, sipas tabelave bashkangjitur këtij vendimi.

4. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.

6. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.

7. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit , ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

8. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.

9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 15/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 11 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4 paragrafi 11 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës jep opinion dhe pajtohet me kandidaturat e propozuara për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për kandidatët në vijim:

   1.1. Lekë Zherka;
   1.2. Ardi Shita dhe
   1.3. Flamur Keqa.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 16/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Organizativ për Festën memoriale të Turqve të Kosovës për përkrahje financiare në vlerë prej 15,000.00 (pesëmbëdhjetë mijë) euro për festimin e 23 prillit, ditës së komunitetit Turk në Kosovë.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, kodi buxhetor 15600, dhe barten në xhirollogarinë e Këshillit Organizativ për Festën memoriale të Turqve nr. 17-01-0016000526.56 në bankën komerciale NLB.

3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 17/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

# V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 1,000,000 (një milion euro) për shërimin e fëmijëve të cilët vuajnë nga kanceri, leukemia dhe sëmundjet e ngjashme.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga programi-Shpenzimet e paparashikuara (kodi 232-180), kategoria ekonomike Rezerva, 500,000 euro dhe kategoria ekonomike kapitale 500,000 euro dhe transferohen në Ministrinë e Shëndetësisë, në nën programin 716-01, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.

3. Obligohet Ministria e Financave, që mjetet nga pika 1. e këtij vendimi t'i bartë në llogarinë e Ministrisë së Shëndetësisë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

Nr. 18/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

# V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare shtesë për mbrojtën e grave dhe fëmijëve në shumë prej 150,000.00 euro në vit.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen në mënyrë proporcionale nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

3. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi do të shfrytëzohen për nevoja të strehimit, Riintegrimin e grave dhe fëmijëve, kompensimin e viktimave, edukimin kundër dhunës në familje dhe zbatimin e Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

4. Obligohen Ministritë nga pika 2. e këtij vendimi që brenda një jave ta njoftojnë Ministrinë e Financave për zbatimin e obligimeve të dala nga ky vendim.

5. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi barten në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në kodin nr. 006 kategoria ekonomike e transfereve dhe subvencioneve.

6. Obligohen ministritë nga pika 2. për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet nga muaji maj.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 19/181
Datë: 02.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014, mori:

## V E N D I M

1. Të ulet pagesa për semestra për studentet e studimeve Bachelor dhe Master në shumë prej 50 %.

2. Të ulen pagesat për ushqim në Mensë dhe strehim në Konvikte në shumë prej 50 %.

3. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet nga muaji maj.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë